REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTARI TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI K.K.T-së

Z.EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetari Këshillit Bashkiak

Z. ALTIN IDRIZI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 102 Datë 20.06.2019

Kryetari i Bashkisë

Z.QAZIM SEJDINI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA ELBASAN

DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROÇEDURE TE PERSHPEJTUAR, BASHKIA ELBASAN

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. __, Datë __.__.2019

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit e Projekteve:

Ark. **RAIMOND HAZBALLA**

1000
28.6.2019

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4628/1 Prot Elbasan më, 28.06 2019

VENDIM

Nr. 102 Datë 20/06/2019

«Për disa përmirësime dhe korigjime të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të dt. ___/___/ 2019, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

«Për disa përmirësime dhe korigjime të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar "

Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit", i ndryshuar , në VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" në VKM nr.408 datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar në PPV të miratuar me vendim të KKT Nr.1 datë 29.12.2016, dhe në udhëzimin Nr.1 datë 22.02.2019 Për Hartimin , Bashkërendimin, Miratimin dhe Kontrollin e Proçesit të Rishikimit të Dokumentave të Planeve të Përgjithshme Vendore me Proçedurë të Thjeshtuar dhe interesit të Bashkisë Elbasan.

VENDOSI

1. **Të miratojë materialin, «Për disa përmirësime dhe korigjime të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar"**
2. Ngarkohet për ndjekje dhe zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI K. BASHKIAK
Klajd Gripshi

ZV/KRYETAR K. BASHKIAK
Alketa Ipeku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Përmbajtja e Dokumentit

1. Propozimet për ndryshimet e "Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor" për Bashkinë Elbasan
   1.1 Baza ligjore 3-5
   1.2 Ndryshimet e propozuara në rregullore.....6-12
   1.3 Tabelat me kodet e rrugore dhe ndryshimet që propozohen.....13-39
2. Njësitë strukturore që kërkohen të përjashtohen nga hartimi i PDV.
   2.1 Pasaportat për njësitë strukturore që kërkohen të përjashtohen nga PDV.....40-46
   2.2 Harta nga sistemi GIS i njësive strukturore……....47-51
3. Njësitë strukturore që kërkohen të ndryshohen treguesit nga pasaportat e PPV
   3.1 Pasaportat për njësitë e kërkuara.....52-66
   3.2 Harta nga sistemi GIS i njësive strukturore……67-73
4. Njësitë strukturore me PDV, që propozohen për ndarje në nën/njësi
   4.1 Pasaportat për njësitë e kërkuara.....74-81
   4.2 Harta nga sistemi GIS i njësive strukturore…….82-85
5. Grupi i punës……..86

BAZA LIGJORE PËR KËRKESËN

a. Baza ligjore ku mbeshtet ky vendim eshte Ligji 107/2014 «Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit» i ndryshuar ne nenet si me poshte :

Neni 13

Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë

1. Kryetari i bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për:

b) ndërmarrjen e nismës për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit;

c) hartimin apo rishikimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;

Neni 26

Rishikimi i planeve

1. Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet. Procesi për shqyrtimin e plotë të tyre fillon 2 vjet para përfundimit të afatit të sipërpërmendur, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për miratimin e tyre. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit do të jetë subjekt vlerësimi, në përshtatje me faktorët e rinj, socialë, ekonomikë dhe mjedisorë, të paktën në fund të çdo 5-vjeçari, në përputhje me kornizën kohore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

2. Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e

harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

3. Rregullat dhe procedura e ndryshimit të planeve apo rishqyrtimit të plotë të tyre, sipas këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.

dhe Vendimi i Këshillit të Ministave Nr.686

Neni 11

Rishikimi i dokumentit të planifikimit dhe procedura e thjeshtuar

1. Rishikimi i dokumentit të planifikimit kryhet në përputhje me nenin 26 të ligjit.

2. Rishikimi i çdo dokumenti planifikimi kryhet në përputhje me seksionet përkatëse në këtë rregullore, ku tregohen procesi dhe përmbajtja e dokumentit.

3. Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave.

4. Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe kur përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk cenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;

b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;

c) Sipas pikës 2, të nenit 26, të ligjit.

Neni 12

Hapat e procedurës së thjeshtuar për rishikimin e dokumentit të planifikimit

Procedura e thjeshtuar zhvillohet sipas hapave të mëposhtëm:

1. Nisma, e cila përmban:

a) hartimin e dokumentit të nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

i) qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;

ii) dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;

iii) ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;

iv) përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;

v) planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;

vi) sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

b) këshillimin e projektdokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

2. Hartimi i dokumentit të rishikuar të planifikimit, në bazë të planit të veprimeve, i paracaktuar dhe i dakordësuar në dokumentin e nismës.

b. Shkaqet që sjëllin nevojën e rishikimit dhe ndryshimeve e përcaktimeve të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor janë :

i. *Sipërfaqa e disa njësive strukturore është shumë e madhe vecanërisht në raste kur është parashikuar hartimi i PDV-së .Kërkohet ndarja e ketyre njësive në disa njesi më të vogla.*

ii. *Heqjen e disa njësive strukturore nga kushti për hartimin e PDV-së - pa ndryshuar treguesit urban të përcaktuar në pasaportën përkatëse me arsyetimin se gjendja aktuale e zhvillimit të këtyre njësive strukturore nuk kërkon domosdosmërisht hartimin e PDV-së.*

iii. *Ndarjen e disa njësive strukturore në njësi më te vogla shoqëruar dhe me ndryshimin e kushteve urbane për njësitë e reja sepse se nuk ka pasur informacion të plote për gjëndjen kadastrale dhe e ndërtimeve ekzitues.*

iv. *Shtimin e disa kategorive të lejuara në disa njësi ku është përcaktuar vetëm një kategori e lejuar.Vecanërisht e nevojshme në rastin e sitemeve territoriale natyrore dhe bujqësore.Kërkohet të shtohen kategori apo nënkategori të lejuara ne përputhje me sistemin territorial të përcaktuar.*

v. *Mospërputhje e numrit të kateve dhe lartësisë në metra duke qenë në kontraditë me përcaktimet e VKM-së Nr.408 , datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", e ndryshuar neni 37 'lartësia e ndërtimeve'.*

vi. *Përcaktimet e largesisë nga trupi i rrugës disa nga distancat e vendosura në rregulloren e PPV-së nuk janë në përputhje me përcaktimet e VKM-së Nr.408 , datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", e ndryshuar neni Neni 36"Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës" dhe Ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 ndryshuar me Ligjin Nr. 9808, datë 24.09.2007 ndryshuar me Ligjin Nr.10 488, datë 5.12.2011 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".*

vii. *Nevoja për korrigjimin dhe përmirsimin e disa neneve te rregullores së Planit të Përgjithshem si dhe shtimin e disa neneve të reja. Keto ndryshime janë të nevojshme si pasoje e ndryshimit të legjislacionit përkatës pas miratimit të Dokumentit të PPV-së.*

viii. *Gabime teknike në hedhjen e të dhënave në tabelat e pasaportave te cilat kane mosperputhje midis hartave dhe tabelave.*

Bashkia Elbasan, kërkon të ndërhyje për disa përmirësime dhe korigjime në PPV e miratuar nga KKT me Nr 1. Datë 29.12.2016 me procedurë të përshpejtuar.

1. Në dokumentin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Elbasan, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në Nenin 2.2.1 e Rregullores së PPV, bashkia kërkon të bëjë përshtatjen e përkufizimeve sipas VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 "*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*" pikat:

Ne rregullore eshte:

- **Rizhvillim** (*Redevelopment*): Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet më tej edhe në: Zhvillim që kryhet përsëri në një zonë e cila është zhvilluar më parë. Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese, si të formës e strukturës, ashtu edhe funksioneve dhe/ose treguesve të zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).

Nryshohet ne, "**Rizhvillim**", procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një territori, i cili është i ndërtuar, por i degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.

- **Ripërtëritje** (*Regeneration, Reneëal, Revitalization, Requalification,* që nënkupton Rigjenerim, Rinovim, Rijetësim, Rivitalizim, Rikualifikim): Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet më tej edhe në: Një formë rizhvillimi që ka për qëllim të risjellë në jetë apo funksion zona të caktuara të cilat e kanë humbur funksionin e mëparshëm, janë degraduar fizikisht, nuk janë më tërheqëse dhe të frekuentuara, paraqesin mungesë sigurie, kanë rënie të vlerës së pronës dhe kanë nevojë për rikonceptim nga pikëpamja e projektimit urban, arkitekturor dhe të peizazhit urban. Zona të tilla mund të jenë aktualisht në funksion, por janë të vjetëruara e jo cilësore ose mund të jenë jashtë funksionit, si p.sh. disa parkime apo qendra tregtare të braktisura dhe me infrastrukturë ekzistuese etj. (*greyfields*) në qytete. Zonat industriale të braktisura apo jashtë funksionit dhe me ndotje (*broënfields*) trajtohen përmes rehabilitimit mjedisor (si më poshtë), por paralelisht edhe me rigjenerim urban, duke pasur për qëllim rifutjen e tyre në treg dhe veprimtari të rritjes ekonomike.

Ndryshohet ne "**Rigjenerim/përtëritje**", procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi.

- **Konsolidim** (*Consolidation,* që nënkupton edhe Kompaktësim): Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet më tej edhe në: Është një proces zhvillimi dhe rizhvillimi në të cilin konsolidohet karakteri dhe tipologjia ekzistuese e zonës (urbane ose bujqësore) dhe për këtë kryhen punime ndërtimi, rindërtimi, ristrukturimi, rigjenerimi të pjesshëm, mbushjeje urbane, konservimi dhe pastrimi. Këto punime kombinohen në pesha të ndryshme.

Ndryshohet ne, "**Konsolidim**", procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës e të strukturës urbane ekzistuese, duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara.

- **Dendësim** (*Densification*): Kjo ndërhyrje propozon rritjen e dendësisë së zhvillimit të zonave urbane me dendësi të ulët, duke promovuar përdorimin më efiçient të tokës, si dhe të rrjeteve të shërbimeve dhe infrastrukturave. Dendësimi ka dy nënraste si më poshtë. Nëse

të dyja nënrastet janë të pranishme në një zonë, atëherë përdoret thjesht termi "dendësim".

a. **Mbushje Urbane** (*Urban Infill*): Kjo është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja dhe me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra, treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me ata të parcelave që kanë ndërtime në momentin e mbushjes. Përgjithësisht, ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

b. **Intensifikim** (*Intensive development*): Kjo është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit si në nivel zone, ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose ai i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave. Intenstifikimi përfshin edhe procesin e mbushjes, por nuk synon të ruajë karakterin dhe tipologjinë ekzistuese në zonë. Ndryshon nga rizhvillimi, pasi nuk synon të ndryshojë funksionin e zonës dhe, përgjithësisht, përdoret në zona (kryesisht) banimi.

Ndryshohet ne "***Dendësim***", Procesi i rritjes së dendësisë së ndërtimit në një territor të caktuar.

- **Konservim, Ruajtje** (*Conservation, Preservation*): Përveç sa parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM, në këtë rregullore ky term thellohet edhe më tej në: Procesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Procesi i konservimit/ruajtjes nuk nënkupton ngrirje, por shmangie nga aktivitetet dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet të cilat janë subjekt i konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligjente e duke shmangur çdo lloj aktiviteti apo ndërhyrjeje dëmtuese/ndotëse. Masat që merren mund të përfshijnë si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen e tyre natyrore për t'i mbrojtur nga ndërhyrjet me karakter dëmtues/ndotës. Në rastin e zonave historike mund të përfshihen edhe procese rigjenerimi pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndryshohet ne, "**Konservim**", procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar të formën e tij ekzistuese/aktuale.

Bashkia kërkon ndryshimin e nenit 3.1.5 në rregulloren e PPV.
Në dokumentin e rregullores është:

3.1.5 Nëse në njësitë strukturore të cilat i përkasin sistemit natyror apo kanë kategori të përdorimit bazë Natyror dhe/ose Ujëra ka edhe ndërtime për qëllime banimi, këto ndërtime administrohen nga pronarët përkatës sipas legjislacionit në fuqi për burimet dhe zonat natyrore, pa e ndryshuar funksionin e tyre "banim". Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, në këto ndërtime banimi mund të shtohet deri në një kat në lartësi, nëse sistemi konstruktiv e lejon. Materialet e përdorura për ndërtim janë dru dhe/ose gur i zonës në të cilën ato ndodhen.

Ndryshohet në, nëse në njësitë strukturore të cilat i përkasin sistemit natyror apo kanë kategori të përdorimit bazë Natyror dhe/ose Ujëra ka edhe ndërtime për qëllime banimi ose hotelerie, këto ndërtime administrohen nga pronarët përkatës sipas legjislacionit në fuqi për burimet dhe zonat natyrore, pa e ndryshuar funksionin e tyre "banim" apo "hoteleri". Përvec rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, në këto ndërtime mund të shtohen deri në një kat në lartësi, nëse sistemi konstruktiv e lejon. Materialet e përdorura për ndërtim janë dru dhe/ose gur i zonës në të cilën ato ndodhen.

Bashkia kërkon ndryshimin e nenit 3.4 në rregulloren e PPV.
Në dokumentin e rregullores është:

Për zonat e ndërtuara me banesa të larta shumëfamiljare dhe me njësi ekonomike për shërbime, parcela minimale, në rastet kur ndërtimi nuk realizohet me PDV, është 1,500 m^2;

Të ndryshohet, Për zonat e parashikuara me banesa të larta shumëfamiljare dhe me njësi ekonomike për shërbime **deri në 5 kat,** parcela minimale në rastet kur ndërtimi nuk realizohet me PDV, është **1.000 m2.**

Bashkia kërkon ndryshimin e nenit 3.3.1. në rregulloren e PPV.

Vija e ndërtimit përcaktohet nëpërmjet rregullave të distancave të objekteve nga kufiri i pronës **dhe nga rruga** në njësitë strukturore dhe zonat me prioritet zhvillimi. Për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore, vija e ndërtimit respekton:

Të ndryshohet fjala "dhe nga rruga", "**dhe nga kufiri anësor i profilit te rrugës**".

Bashkia kërkon ndryshimin e nenit 3.3.1. në rregulloren e PPV.

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht) për ndërtim, sipas rregullores së planifikimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është raporti i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së ndërtueshme. Ksht-ja për ndërtim matet në përqindje (%).

Të shtohet fjalia: Në rastet e ngritjes katit, KSHT të mos merret parasysh, pasi ndërtesa e katit të pare është ekzistuese).

Bashkia kërkon ndryshimin e nenit 7.1.9. në rregulloren e PPV.
Si rregull i përgjithshëm, ndërhyrjet konsoliduese, ristrukturuese, rindërtuese, riparuese, rehabilituese, restauruese, rikrijuese, pastruese, reklamuese, të mbushjes urbane, të trajtimit peizazhistik dhe ato konservuese realizohen mbi bazën e projekteve të dizajnit, arkitektonike, konstruktive, inxhinierike, peizazhit, mjedisore, sipas rastit dhe jo mbi bazën e PDV-së.
Te shtohet fjalia: Ne keto raste te operohet direkt me leje ndertimi sipas rastit.

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË E KATEGORISË BAZË BUJQËSI.

1. Kategoria bazë Bujqësi (B) e përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, përfshin çfarë nuk kufizohet vetëm në toka bujqësore, fusha bujqësore, tarraca të mbjella me ullishte, vreshta, dru-frutore, prodhimet e serave, struktura për prodhimin e vajrave, të shitjes, të magazinimit, agro-turizëm, etj.

2. Strukturat e banimit ekzistuese në momentin e hartimit të këtij plani, në toka bujqësore të kategorisë së bonitetit, nga 1 deri në 4, do te kenë mundësinë vetëm të kryejnë punime të mirmbajtjes së zakonshme/ristrukturimit, por në asnjë mënyrë zhvillimin duke shtuar sipërfaqe ndërtimore apo duke ndryshuar funksionin.

5. Brenda kategorisë Bujqësi (B) lejohen kombinime të kësaj kategorie me këto kategori bazë të tjera si dhe nënkategoritë e tyre:

g. S - Nënkategoritë e kategorisë bazë (S) shërbime, në funksion të bujqësise (si agro-ferma, restorante, ambjente ekspozimi apo magazinimi të produkteve bujqësore, etj)

h. AS - Nënkategoritë e kategorisë bazë, (AS) arsim në lidhje me bujqësine

SH - Nënkategoritë e kategorisë bazë (SH) shëndetsi

j. IN - Nënkategoritë e kategorisë bazë (IN) infrastrukturë

k. N - Nënkategoritë e kategorisë bazë (N) natyrë

TIPOLOGJITË E STRUKTURAVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN, PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE QË NDËRTOHEN NË TOKË BUJQËSORE.

1. Në kuptimin e kësaj rregullore, përkufizimi dhe rregullat e zhvillimit të strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore, i referohen legjislacionit të posacëm të Ligjit nr.8752, date 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të adminisistrimit dhe mbrojtjes së tokës" të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipeve, rregullave, kritereve për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore" dhe legjislacionit sektorial për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, janë:

VI. stallat për mbarështimin e kafshëve dhe objektet ndihmëse funksionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me depo silazhi, hangar, silos, ambiente për përpunimin e ushqimeve, sallë mjeljeje, padoqe, plehrishte, depozita uji;

VII. serat me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën;

Vlll. objektet ndihmëse funksionale të serave, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me magazina për standardizimin e prodhimit dhe mbajtjen e pajisjeve, imputeve;

IX. objektet për tharjen dhe trajtimin paraprak të nevojshëm të produkteve në kultura, të tilla si bimët medicinale etj.;

X. objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë dhe ato frigoriferike;

XI. objekte për përpunimin e produkteve primare, bujqësore dhe blegtorale;

XII. Thertoret.

2. Keto struktura planifikohen bazuar në analizat e përvitshme të sektorit të bujqësise dhe blegtorisë, duke marre në konsideratë dhe nevojat e zonave specifike. Në çdo rast ndërtimi i këtyre strukturave do të kryehet në zbatim të legjislacionit në fuqi duke vlerësuar ndikimin në mjedis që sjell zhvillimi

1. Në të gjitha rastet ndërtimet e objekteve ndihmëse funksionale për tipat sipas nenit 43, të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a. Zhvillimi maksimal i strukturave të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit 0.03, në njësitë strukturore që nuk kanë parametra zhvillimi;

b. Të zhvillohen në një kat të vetem dhe të respektojnë lartësine maksimale 4,50 metër, me përjashtim të oxhakeve, silosevë dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike;

c. Të respektohet distanca minimale 5 metër nga kufijtë e pronës;

d. Të realizohen sipas tipologjive të përshtatshme për funksionin që do të kryejnë dhe që nuk lejojnë ndryshimin e destinacionit të përdorimit.

2. Ndërtimet e reja të stallave lejohen me kusht që të garantojnë menaxhimin e jashtëqitjeve shtazore, me filtrim paraprak.

3. Stallat, që mbarështojne mbi 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet te kenë këto karakteristika:

a. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

i. 20 metër nga kufijtë e pronës;

ii. 500 metër nga qendrat e banuara;

iii. 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

b. Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m;

c. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 0.5 m2/m2•

4. Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës të jenë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3.

5. Për stallat që mbarështojnë 5-10 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 5 metër, ndërsa nga banesa më e afërt 50 metër. Karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij neni.

6. Strukturat për grumbullimin e jashtëqitjeve me origjinë shtazore duhet të vendosen në distancë jo më të vogël se 50 metër nga banesat për stallat me 5-10 njësi gjedhi dhe 100 metër për stallat më të mëdha.

7. Sipërfaqja e serave me themele të vazhduara, të cilat janë te lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk duhet të tejkalojë 70% të sipërfaqes së pronës.

8. Për serat e përcaktuara në pikën 7 duhet të respektohen distancat e mëposhtme:

a. jo me pak se 5 metër nga banesat ekzistuese në të njëjtën ngastër dhe 10 metër nga banesat e tjera;

b. jo më pak se 3 m nga kufiri i pronës.

9. Për serat e tipave të tjera, të cilat nuk janë të lidhura në menyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk kërkohet pajisja me një leje ndeërtimi dhe ato janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh. Distancat për ndërtimin e tyre janë te njëjta me ato të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni.

10. Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojne kushtet e mëposhtme:

a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej, 1 m3/m2;

b. Të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.

11. Ndërtimet e objekteve për thertore duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit, prej 1 m3/m2;

b. Të respektojnë distancat mininale të mëposhtme:

i. 20 metër nga kufijtë e pronës;

ii. 500 metër nga qendrat e banuara;

iii. 100 metër nga banesa më e afërt, e vecuar nga qendra urbane.

12. Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në të gjitha pikat e këtij neni zbatohen

në të gjitha rastet, përvecse kur me akte të tjera, ligjore e nënligjore, përcaktohet ndryshe.

RREGULLA DHE KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMET NË TERRITORIN NATYROR.

1. Në kuptimin e kësaj rregullore, territori natyror përfshin të gjithë territorin natyror, pjesë të sistemit natyror, të përbërë nga male, kodra, mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, zonat e mbrojtura natyrore, peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe të gjitha hapësirat që përkufizohen nga ky plan me kategorinë e përdorimit bazë natyrë (N).

2. Nisur nga tërësia territoriale, nevoja e shfrytëzimit të potencialeve të pashfrytëzuara të mjedisit natyror, per aktivitete rekreative, stimulimin e ekonomise kapilare prane fshatrave periferike te territorit administrativ, nxitjen e zhvillimit turistik, etj, lejohen kombinime te kategorise baze natyrë, me kategori të tjera sipas përcaktimeve të nenit 20 të kësaj rregullore zhvillimi.

3. Në respektim të përcaktimeve të këtij neni dhe të nenit 20 të kësaj rregullore, lejohen zhvillime për keto nënkategori sipas kushteve të mëposhtme:

a. Për kategorinë banim, komplekse banesash vetëm për qëllime turizmi familjar dhe jo për strehim primar, me intensitetin 0.05 për parcelë të përfshirë në zhvillim dhe lartësi maksimale 2 kate.

b. Për kategorinë (AR), për struktura apo ndërhyrje me destinacion rekreativ, socia I apo sport iv, me intensitet 0.1.

c. Për kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit arsim (AS) dhe shëndetsi (SH), me intensitet 0.2.

d. Për nënkategoritë e lejuara të kategorisë bazë institucione (IS) me intensitet 0. 15.

e. Për nënkategoritë e lejuara të kategorisë bazë shërbime (S), me intensitet 0.06.

f. Në rastet e parcelave truall, intensiteti i ndërtimit lejohet 0.3 për të gjitha zhvillimet sipas nënkategorive të përputhshme me ketë përdorim parësor.

4. Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në të gjitha pikat e këtij neni zbatohen

në të gjitha rastet, përveç;se kur me akte të tjera, ligjore e nënligjore, përcaktohet ndryshe.

BANESAT FAMILJARE NË TERRITORIN RURAL.

1. Lejohet zhvillimi i strukturave individuale me përdorim banim, në njësitë strukturore me përdorim urban me kushtin e respektimit të parametrave zhvillimore sipas parashikimeve të përcaktuara nga kjo rregullore për territorin rural.

2. Në rastet kur kategoria e përdorimit urban shtrihet edhe në njësi të cilat si pasojë e përdorimeve kryesore të lejuara të tyre nuk kanë kushte zhvillimore në pasaportat e tym, atëherë për këto njësi, lejohet të zhvillohen struktura banimi vetëm në zonat urbane të identifikuara nga harta e përdorimit të tokës, sipas shtrirjes të përdorimit urban në territor, me intensitet maksimal 0.6 për parcelë, dhe lartësi maksimale 2 kate.

3. Në rastin e zhvillimit të strukturave individuale, zhvilluesi merr përsipër për ndërtimin me shpenzimet e veta të të gjithë infrastrukturës inxhinierike dhe teknike të nevojshme për shfrytëzimin e territorit rural për banim.

4. Në të gjitha rastet e kërkesave të zhvillimit për banim në territorin rural, në të cilin nuk është zhvilluar infrastruktura inxhinierike, sipas parashikimeve të këtij neni dhe kësaj rregullore zhvillimi, struktura e propozuar do të parashikojë realizimin e infrastrukturës septike sipas standarteve teknike.

5. Për të gjitha lejet e ndërtimit të lejuara sipas përcaktimeve të këtij neni, rendi dhe grafiku i punimeve ndërtimore do të kërkohet të parashikojë realizimin e infrastrukturës inxhinierike për furnizimin me ujë dhe depozitimet septike, sipas standarteve të përcaktuara nga ky nen dhe kjo rregullore zhvillimi, përpara fillimit të punimeve ndërtimore për zhvillimin e strukturës së banimit. Vetëm pas kontrollit nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit të territorit për implementimin e infrastrukturës inxhinierike, do të lejohet fillimi i punimeve ndërtimore për strukturat e banimit.

6. Përcaktimet e të gjitha pikave të këtij neni, vlejnë dhe për të gjitha kategoritë e përdorimeve të tjera.

SHËNIM

Për ato parcela pronësie të mbetura për zhvillim, të cilat kanë kontribuar me sipërfaqe publike rrugë trotuare etj, në zbatim të studimeve të mëparshme, sipërfaqet e mbetura zhvillohen tërësisht, me intensitet përtej vlerës së përcaktuar në plan/rregullore, me lartësi maksimale të lejuar jo më shumë se lartësia e objektit më të lartë ekzistues brenda kësaj njësie, duke respektuar vetëm distancat nga trupi i rrugës parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi .

G. NDRYSHIME NË SISTEMIN RRUGOR SIPAS FUNKSIONALITETIT

HARTA E SISTEMIT RRUGOR MIRATUAR NË PPV



Neni 5.2.1 "Kategoritë dhe kushtet teknike të sistemit rrugor sipas funksionalitetit"
Aktualisht në rregullore ky nen paraqitet si më poshtë:

Kategoritë	Kodi	Nr. korsi	Korsi emergjence	Transport publik	Bicikletë	Trotuar	Gjelbërim	Ndriçim	Vijë ndërtimi
Autostrada_by pass (A)	A	4	PO, 2 nga 3 metra secila	PO (transporti ndërqytetas)	JO	JO	PO	PO	60
Rrugë ndërqytetase (ND)	B,C,D	2-4	JO	PO (jo në të gjithë infrastrukturën rrugore)	PO (jo në të gjitha itinerarët)	PO (në zonat e banuara)	PO	PO	40,30,20
Rrugë kolektor (KOL)	D,E	2-4	JO	PO (jo në të gjithë infrastrukturën rrugore)	PO (jo në të gjitha itinerarët)	PO (në zonat e banuara)	PO	PO	20,5
Unaza propozuar (U)	D	4	JO	PO	PO (jo në të gjitha	PO	PO	PO	20
Rrugë bujqësore (Bu)	C,F	1-2	JO	JO (vetëm në rrugët interurban e dytësore)	JO	Kryesisht JO por në zonat e banuara ka trotuar	JO në rrugët bujqësore	JO (vetëm në rrugët interurban ne dytësore ka	30,20
Rrugë kodrinore (Ko)	C,E,F	1-2	JO	JO	PO (jo në të gjitha	PO (në zonat e banuara	PO	PO	30,5,20
Rrugë rurale (Ru)	C,F	2	JO	PO (jo në të gjithë infrastrukturën rrugore)	PO (jo në të gjitha itinerarët)	PO (në zonat e banuara)	PO	PO	30,20
Rrugë të brëndshme (Br)	D,E,F	1-3	JO	JO	PO (jo në të gjitha	PO (në zonat e banuara	PO	PO	20,5,20
Rrugë të vogla (Vo)	C,E,F	1-2	JO	PO (jo në të gjithë infrastrukturën	PO (jo në të gjitha itinerarët)	PO (në zonat e banuara)	PO	PO	30,5,20
Aks lumor (AL)	E-F	1-2	JO	JO	PO (jo në të gjitha itinerarët)	PO (në zonat e banuara)	PO	PO	5,20

Bashkia kërkon të bëhen ndryshimet si më poshtë:

Kategoritë	Kodi	Nr. korsi	Korsi emergjence	Transport publik	Bicikletë	Trotuar	Gjelbërim	Ndriçim	Vijë ndërtimi
Autostrada_by pass (A)	A	4	PO, 2 nga 3 metra secila	PO (transporti ndërqytetas)	JO	JO	PO	PO	60 30 m ne zone te banuar
Rrugë ndërqytetase (ND)	B,C,D	2-4	JO	PO (jo ne te gjithe infrastrukturën rrugore)	PO (jo ne te gjitha itineraret)	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	40,30,20 20,10,PA ne zone te banuar
Rrugë kolektor (KOL)	D,E	2-4	JO	PO (jo ne te gjithe infrastrukturën rrugore)	PO (jo ne te gjitha itineraret)	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	20,5 10,5
Unaza propozuar (U)	D	4	JO	PO	PO (jo ne te gjitha	PO	PO	PO	20 5m ne zone te
Rrugë bujqësore (Bu)	C,F	1-2	JO	JO (vetëm ne rrugët interurban e dytësore)	JO	Kryesisht JO por ne zonat e banuara ka trotuar	JO ne rrugët bujqësore	JO (vetëm ne rrugët interurbana ne dytësore ka	30,20 10,5 ne zone te banuar
Rrugë kodrinore (Ko)	C,E,F	1-2	JO	JO	PO (jo ne te gjitha itinerar	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	30,5,20 10,5,5 ne zone te banuar
Rrugë rurale (Ru)	C,F	2	JO	PO (jo ne te gjithe infrastrukturën rrugore)	PO (jo ne te gjitha itineraret)	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	30,20 10,5 ne zone te banuar
Rrugë të brendshme (Br)	D,E,F	1-3	JO	JO	PO (jo ne te gjitha itinerar	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	10,5,10 5,3,5 ne zone te banuar
Rrugë të vogla (Vo)	C,E,F	1-2	JO	PO (jo ne te gjithe infrastrukturën	PO (jo ne te gjitha itineraret)	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	30,5,20 10,5,5 ne zone te
Aks lumor (AL)	E-F	1-2	JO	JO	PO (jo ne te gjitha itineraret)	PO (ne zonat e banuara)	PO	PO	5,20

Tabelat e specifikuara te rrugeve sipas kodeve te propozuara nga bashkia si me poshte:

Shtojca2: Tabela e Rrugëve ***(Bashkia Elbasan, propozon ndryshimin e shtojcës 2 sipas kolonës së fundit në përputhje me VKM. Nr.408)***

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë bujqësore	INTERURBANE DYTESORE	9	Bu	Bu-A	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	INTERURBANE DYTESORE	8	Bu	Bu-Q	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	INTERURBANE DYTESORE	9	Bu	Bu-V	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	INTERURBANE DYTESORE	8	Bu	Bu-Z	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë kodrinore	INTERURBANE DYTESORE	10	Ko	Ko-C	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë kodrinore	INTERURBANE DYTESORE	10	Ko	Ko-D	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	11	ND	ND-B	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	8	ND	ND-D	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	12	ND	ND-F	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	PO	PO	PO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	10	ND	ND-G	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	8	ND	ND-H	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	11	ND	ND-O	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	11	ND	ND-P	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërti	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	10	ND	ND-Q	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetë se	INTERURBANE DYTESORE	8	ND	ND-S	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	10	Ru	Ru-A	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	PO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-AA	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-B	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-C	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-CC	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	10	Ru	Ru-D	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	10	Ru	Ru-D	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-DD	C	Ndërtim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-DD	C	Ndërtim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	13	Ru	Ru-EE	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-F	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	13	Ru	Ru-FF	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	PO	PO, nga një anë	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-M	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-S	C	Ndërtim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuara	30	10 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-U	C	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtim	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	8	Ru	Ru-V	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-AL	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, në zonat e banuar	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-AM	C	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-BBB	C	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, në zonat e banuar	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-FF	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	10	Vo	Vo-FF	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	10	Vo	Vo-FFF	C	Ndërtim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-GG	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, në zonat e banuar	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	10	Vo	Vo-L	C	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-MMM	C	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, në zonat e banuar	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-P	C	Zgjerim	PO	JO	2	PO	PO	JO	JO	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	10	Vo	Vo-QQ	C	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	PO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	10	Vo	Vo-SS	C	Ndërtim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	30	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	INTERURBANE DYTESORE	8	Vo	Vo-X	C	Miks (Zgjerim+N dërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë		10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë rurale	INTERURBANE DYTESORE	13	Ru	Ru-T	C	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	PO	PO	PO	PO, nga dy anët		10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë ndërqytetëse	INTERURBANE KRYESORE	19	ND	ND-C	B	Zgjerim	PO	JO	4	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	40	20 m në zonë të banuar
Rrugë ndërqytetëse	INTERURBANE KRYESORE	19	ND	ND-E	B	Zgjerim	PO	JO	4	PO	PO	JO	PO, nga dy anët	40	20 m në zonë të banuar

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë të vogla	LOKALE	6	Vo	Vo-AA	F	Miks (Ekzistuese+ Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	LOKALE	8	Vo	Vo-BBB	F	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, në zonat e	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të vogla	LOKALE	6	Vo	Vo-FFF	F	Ndërtim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë kodrinore	LOKALE	10	Ko	Ko-E	F	Miks (Ekzistuese+ Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë kodrinore	LOKALE	10	Ko	Ko-F	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Aks lumor	LOKALE	6	AL	AL-A	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	
Aks lumor	LOKALE	5	AL	AL-B	F	Ndërtim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	
Aks lumor	LOKALE	6	AL	AL-E	F	Ristrukturim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	
Aks lumor	LOKALE	6	AL	AL-F	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AD	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AE	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AF	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-AI	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-AN	F	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-AR	F	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-B	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	8	Br	Br-C	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-D	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-DD	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-E	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-F	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-FF	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-GG	F	Ndërtim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-N	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	PO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-OO	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-PP	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	PO, nga një anë	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-QQ	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-RRR	F	Ristrukturim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-SS	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	5	Br	Br-TT	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-TTT	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-UU	F	Ekzistuese dhe mirëmbajtje	PO	JO	1	JO	PO	JO	PO, nga dy anët	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë të brendshme	LOKALE	6	Br	Br-UUU	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë të brendshm e	LOKALE	6	Br	Br-VVV	F	Ristrukturim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (3 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-B	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	4	Bu	Bu-C	F	Ristrukturim	JO	JO	1	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-D	F	Ndërtim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-E	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-F	F	Ristrukturim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-G	F	Ristrukturim	PO	JO	1	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	4	Bu	Bu-H	F	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	JO	JO	1	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	4	Bu	Bu-I	F	Miks (Zgjerim+Ndërtim)	JO	JO	1	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-L	F	Zgjerim	PO	JO	1	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-M	F	Ndërtim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)

Rrugë sipas funksionit	Kodi rrugor	Gjerësia e propozuar	Kodi (funksioni)	Kodi (prerja)	Kodi (gërma)	Ndërhyrja	Ndriçim	Korsi emergjence	Korsi auto.	Transporti publik	Gjelbërim	Korsi biçiklete	Trotuari	Vija e ndërtimit	Vija e ndërtimit e propozuar
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-N	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
Rrugë bujqësore	LOKALE	6	Bu	Bu-O	F	Zgjerim	PO	JO	2	JO	PO	JO	JO	20 (7 m në zonë të banuar)	10 (5 m në zonë të banuar)
